

BAROMETRI I SIGURISË SË JETËS DHE I PUNËS SË POLICISË SË SHETIT PËR VITIN 2025

Nga Eduard Zaloshnja, QENDRA AGENDA

Vdekjet rrugore dhe nga krimi përbëjnë gjysmën e vdekjeve jonatyrale në Shqipëri. Parandalimi i tyre është detyrë parësore e Policisë së Shtetit. Te gjysma tjetër e vdekjeve jonatyrale mbizotërojnë vetëvrasjet, vdekjet në punë, etj. Parandalimi i tyre është detyrë parësore e organeve të tjera shtetërore.


Siç ilustron në tabelën e mëposhtme, vdekjet rrugore dhe nga krimi kanë shënuar një reduktim drastik në 15 vjetët e fundit në Shqipëri – 43.5% janë reduktuar vdekjet rrugore dhe 60.6% vdekjet nga krimi.

Vdekjet nga:	2025	2010	Ndryshimi
Aksidentet rrugore	199	352	-153
Vrasjet e qëllimshme	43	109	-66
GJITHSEJ	242	461	-219

Por shifrat e mësipërme nuk na japin një tablo të plotë. Sepse ndërkohë që vdekjet rrugore pothuaj janë përgjysmuar në 15 vjetët e fundit, numri i automjeteve me targa shqiptare pothuaj është trefishuar – nga 380 mijë më 2010, arritën në 1 milion më 2025 (pa llogaritur këtu numrin e automjeteve me targa të huaja që futen me shumicë në Shqipëri).

Po të llogarisim indeksin e vdekshmërisë rrugore (vdekje rrugore për 100 mijë automjete me targa shqiptare), rezulton se vdekshmëria rrugore ka qenë pothuaj pesëfish më e lartë më 2010, krahasuar me 2025 (shihni grafikun e mëposhtëm).


Indeksi i Vdekshmërisë Rrugore (vdekje për 100 mijë mjete me targa shqiptare)




Po si krahasohemi ne me mesataren e vdekshmërisë rrugore të Bashkimit European dhe me të fqinjit tonë verior Mal i Zi (vend kandidat për në BE)?

Në qoftë se vdekjet e këmbësorëve/biçiklistëve/motoçiklistëve (që përbëjnë aktualisht 57% të gjithë vdekjeve rrugore këtu) do të ishin të krahasueshme në përqindje me BE-në (20%), ne do ta kishim sot indeksin e vdekshmërisë rrugore të barabartë me mesataren europiane! Ndërkohë, vdekshmëria rrugore në Shqipëri është shumë më e ulët se në Malin e Zi (shihni grafikun e mëposhtëm).

Indeksi i Vdekshmërisë Rrugore (vdekje për 100 mijë mjete me targa shtetërore)



Vdekshmëria nga krimi ka qenë mbi dyfish më e lartë më 2010, krahasuar me 2025. Shihni grafikun e mëposhtëm për indeksin e vdekshmërisë nga krimi (vdekje nga krimi për 1 milion banorë).



Po si krahasohemi ne me mesataren e vdekshmërisë nga krimi të Bashkimit European dhe të fqinjit tonë verior Mal i Zi (vend kandidat për në BE)?

Në qoftë se vdekjet nga krimi brenda familjes (që përbëjnë 18.6% të vdekjeve nga krimi gjithsej këtu) do të ishin të krahasueshme në përqindje me BE-në, ne do ta kishim sot indeksin e vdekshmërisë nga krimi diku afër me mesataren europiane! Ndërkohë, vdekshmëria nga krimi në Shqipëri është më e ulët se në Malin e Zi (shihni grafikun e mëposhtëm).



Me rastin e 113-vjetorit të themelimit të Policisë së Shtetit Shqiptar, QENDRA AGENDA zhvilloi një sondazh opinioni për sigurinë e shtetasve dhe punën e Policisë së Shtetit. Linku i pyetësorit u shpërnda me SMS krejt të rastësishme. Plot 1187 banorë të rritur nga i gjithë territori i vendit e plotësuan pyetësorin, duke realizuar kështu një kampion me marzh gabimi statistikor prej 2.9%, maksimumi. Shihni më poshtë rezultatet e sondazhit.

Sa i/e sigurt ndiheni kur ecni vetëm në lagje/fshat, pasi është errësuar?		
	%	Shuma
Sh. i/e sigurt	45.8%	85.3%
I/e sigurt	39.5%	
I/e pasigurt	9.1%	14.7%
Sh. i/e pasigurt	5.6%	

Në zonën ku banoni, kriminaliteti është i ulët apo i lartë?		
	%	Shuma
Shumë i ulët	51.9%	76.1%
I ulët	24.2%	
I lartë	11.6%	23.9%
Shumë i lartë	12.3%	

A reagon shpejt policia ndaj vjedhjeve/grabitjeve/krimeve në zonën ku banoni?		
	%	Shuma
Po	58.8%	70.7%
Anoj po	11.9%	
Anoj jo	13.9%	29.3%
Jo	15.4%	

A e ndieni praninë e policisë në zonën ku banoni?		
	%	Shuma
Po	68.6%	78.5%
Anoj po	9.9%	
Anoj jo	10.9%	21.5%
Jo	10.6%	

A është shqetësim prania e armëve pa leje në lagjen/fshatin ku banoni?		
	%	Shuma
Po	15.1%	25.3%
Anoj po	10.2%	
Anoj jo	10.5%	74.7%
Jo	64.2%	

Çfarë vlerësimi keni për luftën e Policisë së Shtetit kundër mbajtjes pa leje të armëve?		
	%	Shuma
Pozitiv	50.9%	64.3%
Anoj pozitiv	13.4%	
Anoj negativ	16.5%	35.7%
Negativ	19.2%	

Çfarë vlerësimi keni në përgjithësi për punën e Policisë së Shtetit?		
	%	Shuma
Pozitiv	54.2%	70.1%

Anoj pozitiv	15.9%	
Anoj negativ	11.5%	29.9%
Negativ	18.4%	

A mendoni se ka ndikuar puna e Policisë Rrugore për parandalimin e shkeljeve të kudit rrugor?		
	%	Shuma
Po	62.7%	72.2%
Anoj po	9.5%	
Anoj jo	12.6%	27.8%
Jo	15.2%	